



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### SHOQËRIA RAJONALE UJËSJETLLËS KANALIZIME VLORË SH.A

---

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Vlorë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

#### PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Sherbime

#### PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

#### OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Studim Projektim Sistemi i mbledhjes së ujërave të ndotura në zonën e Drimadhes dhe Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura”

#### KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

71335000-5 - Studime inxhinierike

#### VLERA E FONDIT LIMIT:

**19,477,060** (nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë) **lekë PA TVSH** ose **204,162** (dyqind e kater mijë e njeqind e gjashtedhjetë e dy) **Euro pa Tvsh.** (Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 22.05.2026, 1 euro = 95.40 All)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlore sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**Sipas Shtojcës 9 të DST**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2/a dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitetet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

**2.2.2** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e

përcaktimeve në përputhje me Ligjin Nr.10091, datë 05.03.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, (i ndryshuar).

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar.*

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për vitin 2025 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të objektit që prokurohet.

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke qene se kjo procedure prokurimi do te konkludoje me nje kontrate sherbim projektimi per te deshmuar pervojen e meparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 3 viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

### **Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:**

- 3.c2 Troje dhe shpate me qendrueshmeri te ulet
- 5.b Projektim furnizim me uje / kolektore shkarkimi
- 5.c Projektim ujesjelles-kanalizime
- 5.e Vepra te trajtimit te ujit
- 8.a Rivelime inxhinierike.
- 8.d Bazamente gjeodezike
- 8.e Projektim fotogrametrik dhe hartografik
- 9.e Studime e Projektme hidrogjeologjike
- 12e Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet e shpate me qendrueshmeri te ulet dhe per troje ndertimore te shkrfeta me mundesi lengezimi.
- 14 Studime e Projektme te ndertimit te impianteve te trajtimit te ujerave te zeza

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

*Sqarim:* Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” - lidhja 4 “kushte dhe kritere specifike që kryesisht duhen plotësuar për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

KATEGORIA E KËRKUAR	PIKAT E KATEGORISE	PERSHKRIMI PER KATEGORITE
<b>Kat.3.PROJEKTUES KONSTRUKTOR</b>	3.c2 Troje dhe shpate me qendrushmeri te ulet	<i>Bazuar ne termat e references projektuesi konstruktor do te jete i domosdoshem për projektimin e veprave inxhinierike, ndërtimit dhe operimit te Impianteve.</i>
<b>5. PROJEKTUES VEPRRA HIDRAULIKE</b>	5.b Projektim furnizim me uje / kolektore shkarkimi 5.c Projektim ujesjelles-kanalizime 5.e Vepra te trajtimit te ujit	<i>Bazuar ne termat e references projektuesi vepra hidraulike do te jete i domosdoshem për projektimin</i>
<b>8. PROJEKTUES GJEODET</b>	8.a Rivelimet inxhinierike.  8.d Bazamente gjeodezike  8.e Projektim fotogrametrik dhe hartografik	<i>Bazuar ne termat e references projektuesi gjeodet do te jete i domosdoshem për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht me rilevimin e kuotave gjeodezike, kordinative te linjes dhe të gjithë hapësirës ku mendohet të kalojë sistemi i shkarkimit, pusetave te kontrollit , , të jepet plani i piketimit dhe verifikimi paraprak në terren për saktësinë e të dhënave përpara fillimit të projektit të zbatimit .Bazamente gjeodezike , rilevime ne te gjitha shkallet ,</i>

**2.3.3** Një punësim mesatar i të paktën **20 (njëzete) personave**, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

<b>9. STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK</b>	9.e Studime e Projektme hidrogeologjike	<i>Bazuar ne termat e referencës projektuesi gjeolog do te jete i domosdoshem për shërbime të kërkuara të lidhura kryesisht me studimet hidrogeologjike, hartimin e relacionit hidrogeologjik, hartimin preventivit dhe analizat e çmimeve për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objektit inxhinierik përpara fillimit te projektit te zbatimit ,te shërbimeve të lidhura kryesisht me projektimin e strukturave mbrojtese si membrana izoluese, vleresim te struktures gjeologjike , stabilitet te terrenit , perdorimin e metodave gjeofizike per vleresimin e nentokes etj</i>
<b>12.STUDIME TE SIZMIOLOGJISE INXHINIERIKE</b>	e- Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkrifëta me mundësi lëngëzimi.	<i>Bazuar ne termat e referencës projektuesi do te jete i domosdoshem për projektimin dhe për vlerësimin e kushteve sizmike të shpateve në vepren e pastrimit dhe rrezikut nga lëngëzimi i shtresave të mbetjes apo të truallit të bazës.</i>
•	• Studime e Projektme te ndertimit te impianteve te trajtimit te ujerave te zeza	<i>Referuar Termave te referencës, eshte parashikuar ndërtimi i nje impianti</i>

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar.

*Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.*

**Argumentimi:** Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e ketij kriteri per fuqine punetore është bërë në përputhje me realizimin e suksesshëm te sherbimit për objektin.

**2.3.4** Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për ekzekutimin e objektit te prokurimit, te perfshire ne licensen e shoqërisë si drejtues teknik,

të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV ku të kenë të paktën 10 vite eksperiencë , diplomë dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi
- 2 (dy) Inxhinier Hidroteknik
- 2 (dy) Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Topograf.
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Elektronik/Elektroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Gjeofizik

Drejtimesit teknik si më sipër duhet të jenë të punësuar pranë shoqërisë dhe të përmbushin kriteret sipas parashikimeve të vendimit nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

*Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Spas Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Neni 77 Kërkesat për kualifikim, pika 4 Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Stafit i mesipër, do të realizojë projektet sipas kompetencës dhe licences bazuar në VKM nr.759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

**2.3.5** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë staf mbështetës për realizimin e këtij shërbimi punonjësit e mëposhtëm vërtetuar me a) kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezë

pune , licence projektimi dhe të listuar në listpagesat e Shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës:

### **Staf Ndhmës si më poshtë,**

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
  - 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
  - 1 (nje) Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Topograf.
- 
- **1 (një)** punonjës me certifikatë "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë**" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10237 datë 18/02/2010 "Përsigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Përsigurinë në kantier", shoqëruar me kontratën individuale të punës të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.( Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike,grupimi duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 nje punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë")
  - **1 (një)** punonjës i pajisur me certifikatë "**Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**" e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, Për këtë duhet të paraqitet certifikata e tranimit si ekspert për dhenien e ndihmës së parë dhe ndërhyrjes ndaj emergjencave" e dhënë nga një organizem i licencuar,shqiptar ose i huaj, kontrata e punës, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike,grupimi duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 nje punonjës " Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave")
  - **1 (një)** punonjës specialist "**Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin**" nëpërputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin",Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate dhënë nga Drejtoria MZSH, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike,grupimi duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 nje punonjës "Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin")
  - **1 (një)** punonjës me certifikatë "**Ekspert për ndikimin e vlerësimit në mjedis**" (VNM) të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, Grupimi duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist "Ekspert për ndikimin e vlerësimit në mjedis").

*Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimin dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“ , te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit ndihmës i eshte referuar Termave References .

### **2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001-2015** (e vlefshme)/ose/ekuivalent **Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë.**
- b) Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 14001-2015** (e vlefshme)/ose/ekuivalent **Për sistemin e menaxhimit cilesise se Mjedisit.**
- c) Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 45001-2018** (e vlefshme)/ose/ekuivalent **Për sistemin e Menaxhimit të Shendetit dhe Sigurise ne Pune.**
- d) Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 50001:2018** (e vlefshme)/ose/ekuivalent **Për sistemin e Menaxhimit të Energjise.**

Shënim: Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.6 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të

*njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

**ISO 9001:2015** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 9001:2015** me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**ISO 14001:2015** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 14001:2015** me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

**ISO 45001-2018** është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 45001-2018** me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

**ISO 50001:2018** është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e energjisë. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 50001:2018** me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e menaxhimit të energjisë në godinat e impiantit për të bërë ato sa më eficientë dhe duke marrë masa në tërësi për të ulur kostot e harxhimit të energjisë.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve që do shërbejnë për ofrimin e shërbimit të projektimit, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- 2 (dy) Pajisje GPS
- 2 (dy) Total station
- 2 (dy) pajisje Droni i dizajnuar për inspektim, monitorim, detektim i pajisur me LIDAR.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet dokumentacioni i vlefshëm, si më poshtë: dokumentacion për pajisjen në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo

dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

*Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit si pas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertues i kualifikuar i pari, për para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë pajisje, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me realizimin e shërbimit.

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë eksperience të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” i azhornuar.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim**

## ➤ ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

**Shënim:** Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performancë, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

**Kujdes:** Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike dhe fondi limit janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DST

## ➤ SQARIM NË LIDHJE ME MOSNDARJEN E PROCEDURËS NË LOTE:

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

- 1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*
- 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.*

Autoriteti Kontraktor ka arritur në përfundimin se **ndarja në lote nuk është teknikisht dhe funksionalisht e përshtatshme**, për arsyet si më poshtë:

Objekti i prokurimit përbën një projekt inxhinierik të integruar dhe funksionalisht të pandashëm, i cili synon hartimin e një sistemi të unifikuar për mbledhjen, transferimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, duke përfshirë rrjetin e kanalizimeve, kolektorët kryesorë, stacionet e pompimit, strukturat ndihmëse, si dhe projektimin e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) si

pjesë përbërëse e të njëjtit sistem teknik. Sipas detyrës së projektimit, të gjithë këta komponentë janë të ndërlidhur hidraulikisht dhe funksionalisht, pasi dimensionimi i secilit element varet drejtpërdrejt nga parametrat e sistemit në tërësi.

Ndarja e procedurës në lote sipas komponentëve të veçantë, si p.sh. rrjeti i kanalizimeve, stacionet e pompimit, ITUN-i, studimet mjedisore apo modelimi hidraulik, do të krijonte risk të lartë për mungesë koherence teknike ndërmjet zgjidhjeve projektuese, papajtueshmëri në llogaritjet hidraulike, dimensionimin e prurjeve, kapaciteteve të pompimit dhe parametrave të trajtimit biologjik të impiantit, duke cenuar integritetin teknik të projektit përfundimtar. Projekti kërkon analizë të integruar të prurjeve aktuale dhe të perspektivës deri në horizontet e projektimit, si dhe përputhshmëri të plotë ndërmjet kolektorëve, pompimeve dhe kapacitetit të ITUN-it. Gjithashtu, detyra e projektimit kërkon realizimin e studimeve të integruara topografike, gjeoteknike, hidrologjike, mjedisore dhe analizave të shpërndarjes së shkarkimeve, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zgjedhjen e alternativës optimale tekniko-ekonomike dhe mjedisore të sistemit. Kryerja e këtyre elementeve nga operatorë ekonomikë të ndryshëm do të rriste ndjeshëm rrezikun e mospërputhjeve metodologjike dhe vonesave në harmonizimin e dokumentacionit teknik përfundimtar.

Ndarja në lote do të sillte gjithashtu rritje të kompleksitetit administrativ dhe kontraktor për Autoritetin Kontraktor, duke krijuar vështirësi në koordinimin e disa kontratave të ndërlidhura, monitorimin e fazave të projektimit, harmonizimin e produkteve teknike dhe administrimin e përgjegjësive në rast mospërputhjes apo vonesash.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se **mosndarja e procedurës në lote është objektivisht e justifikuar, proporcionale dhe në funksion të garantimit të integritetit teknik, koherencës funksionale, mbrojtjes së mjedisit dhe realizimit eficient të projektit**, pa cenuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke qenë se tregu i shërbimeve të projektimit mundëson pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të specializuar në një procedurë të vetme prokurimi.

## Njesia e Prokurimit

---